



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

*Dokument Parlamentar
Tiranë, më 07.10.2019*

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RININË”

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, mori në shqyrtim projektligjin “Për rininë” në mbledhjen e datave 08.07.2019 dhe 07.10.2019,

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Vasilika Hysi.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm znj. Lorena Haxhiu zëvendësministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Meqënese ndryshimet e Rregullores së Kuvendit lidhur me kërkesat që duhet të përmbushë relacioni që shoqëron projektligjin, kanë hyrë në fuqi pas depozitimit të projektligjit në Kuvend, rregullat e reja të parashikuara në nenin 68 të Rregullores nuk zbatohen për këtë projektligj.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT, RISITË DHE IMPAKTI I PROJEKTLIGJIT

2.1. Qëllimi i projektligjit

Projektligji i ri “Për rininë” ka si qëllim mbrojtjen e të drejtave të të rinjve, përcaktimin e kompetencave të institucioneve qendrore e vendore publike dhe rolit të organizatave që

ushetrojnë veprimtari në fushën e rinisë si dhe krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve për përmbushjen e potencialit të tyre në interes të shoqërisë.

Hartimi i një projektligji të ri për rininë, ka ardhur si pasojë e mungesës së një kuadri ligjor të posaçëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve, në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti në Republikën e Shqipërisë. Politikat rinore, të zhvilluara dhe të parashikuara në Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Veprimit “Për Rininë 2015-2020” kanë pasur si synim rritjen e rolit të të rinjve dhe të organizatave rinore në vendimmarrje dhe sigurimin e efikasitetit të institucioneve shtetërore, të cilat punojnë me çështjet që lidhen me të rinjtë.

Projektligji rregullon masat dhe aktivitetet që do të ndërmarrin institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore, me qëllim fuqizimin e sektorit të rinisë, përmirësimin e statusit social ekonomik të të rinjve dhe krijimin e kushteve për adresimin e nevojave dhe interesave të të rinjve. Projektligji synon të krijojë kushtet e nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve për përmbushjen e potencialit të tyre në interes të shoqërisë, rritjen e rolit të të rinjve dhe të organizatave rinore në vendimmarrje si dhe sigurimin e efikasitetit të institucioneve shtetërore të cilat punojnë me çështjet që lidhen me të rinjtë.

Nëpërmjet kësaj nisme ligjore synohet realizimi i objektivave të mëposhtëm:

- a. Përmirësimi i cilësisë së jetës së të rinjve dhe forcimi i statusit të tyre, përmes zhvillimit të më shumë mundësive në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë dhe rritjen e pjesëmarrjes së plotë të të rinjve në shoqëri e në vendimmarrje;
- b. Plotësimi i kuadrit ligjor e institucional për të rinjtë;
- c. Mbrojtja e të drejtave të të rinjve dhe garantimi i përputhshmërisë me rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare në këtë fushë;
- d. Përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve qendrore e vendore publike si dhe organizatave, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e rinisë;
- e. Krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve për përmbushjen e potencialit të tyre në interes të shoqërisë.

2.2. Risitë e projektligjit

Ky projektligj paraqet risitë e mëposhtme:

- Përfaqëson një akt ligjor të posaçëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve.
- Prezanton mekanizmat e fuqizimit të të rinjve dhe të realizimit të pjesëmarrjes së tyre në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse, duke përcaktuar veprimtaritë të cilat nxisin aktivizimin e të rinjve dhe mbështetjen nga shteti.
- Trajton konceptet e “edukimit joformal për të rinjtë” dhe të “punës rinore” me qëllim vendosjen e disa kritereve bazë për profesionistët që do të punojnë me të rinjtë.
- Përcakton rolin dhe përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse, duke parashikuar detyrat e institucioneve dhe strukturave në nivel qendror dhe vendor.
- Mundëson krijimin e organizmave në nivel qendror dhe vendor që synojnë të rrisin aktivizimin rinor dhe rritjen e bashkëveprimit ndërmjet organizatave rinore e organizatave për të rinjtë dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje

- Parashikon burimet e financimit të politikave, programeve dhe veprimtarive rinore.
- Rregullon bazën e të dhënave për rininë, përmbajtjen e qëllimin e saj për të siguruar informacion të përditësuar për situatën e nevojat e të rinjve, në mbështetje edhe të planifikimit, mbikëqyrjes dhe vlerësimit të ndikimit të politikave rinore në nivel qendror dhe vendor.

2.3 Ndikimi ekonomik dhe social dhe pjesëmarrja në vendimmarrje

Projektligji ka disa ndikime pozitive të rinjtë.

- Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje në nivel qendror dhe vendor dhe qartësimi i përgjegjësive të organeve qendrore dhe vendore në raport me të rinjtë;
- Ndikimi ekonomik. Kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik do të shoqërohen me financimin e projekteve rinore me qëllim fuqizimin e organizatave rinore;
- Ndikim social, pasi do të ofrohen me shumë shërbime për të rinjtë, do të rriten aftësitë e të rinjve, nëpërmjet trajnimeve ose projekteve të ndryshme; krijohen Këshillat rinorë vendorë.
- Nxitja e punësimit. Ndikimi jo i drejtpërdrejtë që ligji do të ketë mbi të rinjtë do të jetë punësimi i të rinjve, nëpërmjet rritjes së kualifikimeve ose rolit të të rinjve në procese vendimmarrëse, që do t'i japë të rinjve përparësi edhe në aspektin e punësimit.

III. PARASHIKIMET KUSHTETUESE DHE AKTET NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E MBROJTJES SË TË RINJVE DHE ANGAZHIMIT TË TYRE NË VENDIMMARRJE

3.1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 54 i Kushtetutës parashikon se:

“1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti...”

Neni 59 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë që parashikon objektivat sociale të shtetit, përcakton se:

“Shteti brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private synon:...
ç) arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë.”

Objektivat Sociale ndryshojnë nga të drejtat dhe liritë themelore, sepse nuk konsiderohen si një e drejtë dhe të mund të atakohen në gjykatë. **Ato janë një detyrim, i cili mbetet mundësi reale e shtetit, pavarësisht standarteve të përcaktuara në Kushtetutë dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore.** Në kuadrin e përpjekjeve për ndërtimin e shtetit social, është e drejtë legjitime e vetë shtetit të rregullojë sistemin e mbrojtjes sociale, duke hartuar dhe zbatuar politikatat dhe strategjitë sociale.

Në këtë kuptim, ligjvënësi duhet të çmojë vetë, sipas përparësive që ai ka vendosur për zhvillimin ekonomik e shoqëror, se cilat janë format më të përshtatshme për balancimin e

interesave duke bërë edhe diferencimet e arsyeshme, pa cenuar parimet dhe normat kushtetuese. Në çdo rast, këto rregullime duhet të përputhen me parimet, vlerat dhe standardet kushtetuese dhe me detyrimet që burojnë nga Karta Sociale Evropiane, që janë barazia, drejtësia sociale, respekti për të drejtat e njeriut dhe ndalimi i diskriminimit.

Shteti, me qëllim garantimin e dinjitetit njerëzor, të një niveli të pranueshëm jetese, si dhe ruajtjen e interesave të të gjitha shtresave të shoqërisë, mund të ndryshojë mekanizmin e realizimit të këtyre të drejtave, veçanërisht kur nuk ka mundësi financiare për rishpërndarje proporcionale të fondeve në dispozicion, ose kur këto masa diktohen nga nevoja për të eliminuar apo parandaluar rreziqe reale ndaj sigurisë ekonomike¹.

3.2 Aktet ndërkombëtare

Mbrojtja e të rinjve është sanksionuar në një sërë aktesh ndërkombëtare, mes të cilave mund të përmendim:

Kartën Sociale Evropiane e ratifikuar me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002. Në preambulën e saj është parashikuar që:

“7. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për mbrojtje të veçantë ndaj rreziqeve fizike dhe morale ndaj të cilave ata ekspozohen.

17. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për mbrojtje të përshtatshme ekonomike, juridike dhe sociale.”

Deklarata e miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara *“Për promovimin ndërmjet të rinjve të idelave të paqes, respektit reciprok dhe mirëkuptimit”*.

Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (2015) 3 *“Mbi aksesin e të rinjve nga grupet e pafavorizuara në të drejtat sociale”*. Rekomandimi bën thirrje shteteve anëtare të zbatojnë politika të qëndrueshme publike të bazuara në dëshmi, të cilat marrin në konsideratë situatat dhe nevojat specifike të të rinjve nga grupet e pafavorizuara. Këto politika duhet të synojnë parandalimin dhe zhdukjen e varfërisë, diskriminimit, dhunës dhe përjashtimit me të cilat ballafaqohen këta të rinj.

Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (2016) 7 *“Për aksesin e të rinjve në të drejta”*. Rekomandimi u jep udhëzime shteteve për përmirësimin e qasjes në arsim, autonominë dhe përfshirjen sociale të të rinjve, lëvizshmërinë, qytetarinë aktive, demokracinë dhe pjesëmarrjen, bashkëjetesën në shoqëri të ndryshme, qasjen në informacion dhe mbrojtjen si dhe qasjen në shërbimet shëndetësore.

Nisma ligjore përmbush një prej Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të Shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara të adoptuara nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara përkatësisht:

“Objektivi 4: *“Sigurimi i arsimit përfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të nxënies gjatë të gjithë jetës për të gjithë”*

Objektivi 8: *Promovimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë dhe produktiv dhe punës së denjë për të gjithë.”*

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.1, datë 06.02.2013 dhe nr. 34, datë 28.05.2012

IV. ÇËSHTJET E DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji nga relatorja dhe anëtarët e komisioni u theksua rëndësia e miratimit të këtij projektligji, i cili synon fuqizimin e të rinjve, përmirësimin e statusit social dhe ekonomik të tyre si dhe krijimin e kuadrit ligjor të nevojshëm për adresimin e nevojave të të rinjve dhe zhvillimin e potencialit të tyre.

Disa nga çështjet që morën vëmendje të veçantë gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit janë të lidhura me:

Së pari, shtimi i funksioneve të njësive të vetqeverisjes vendore në fushën e rinisë

Një çështje e cila mori vëmendje të veçantë gjatë shqyrtimit të këtij projektligji ishte shtimi i një funksioni të ri të deleguar për njësitë e vetqeverisjes vendore lidhur me krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë dhe financimin e krijimit dhe zhvillimit të infrastrukturës rinore. Ky propozim u vlerësua në lidhje me parashikimet e ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, në të cilin është parashikuar se:

“Funksionet u njihen njësive të vetqeverisjes vendore me këtë ligj. Funksione apo kompetenca të tjera mund t’u njihen një, disa apo të gjitha njësive të vetqeverisjes vendore vetëm në bazë të ligjit. (neni 22 pika 2)

“Në çdo rast qeverisja qendrore u garanton njësive të vetqeverisjes vendore mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.” (neni 30).

Ministria propozuese, informoi anëtarët e Komisionit se projektligji është konsultuar me shoqatat përfaqësuese të interesave të njësive të vetqeverisjes vendore dhe nisma ligjore është diskutuar me Këshillin Konsultativ të qeverisjes qendrore me qeverisjen vendore.

Pavarësisht konsultimit të zhvilluar nga ministria përgjegjëse për rininë, Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, fton komisionin përgjegjës të konsiderojë mundësinë e zhvillimit të seancave dëgjimore me shoqatat përfaqësuese të njësive të vetqeverisjes vendore, për të marrë opinion e tyre mbi zbatimin e kompetencave të parashikuara për to nga ky projektligj.

Në lidhje me mbështetje e nevojshme në burime njerëzore dhe financiare, për realizimin e kompetencave të parashikuara në këtë projektligj nga njësitë e vetqeverisjes vendore, komisioni vlerësoi se bazuar në Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore dhe ligjin nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” funksionet e deleguara për bashkitë në kuadër të hartimit dhe zbatimit të politikave vendore në fushën e rinisë duhet të shoqërohen edhe me kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe financiare për ushtrimin e këtij funksioni.

Në këtë kuadër Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut sjell në vëmendje të ministrisë përgjegjëse për rininë, nevojën për bashkëpunimin me ministrinë përgjegjëse për financat, gjatë hartimit të kërkesave buxhetore dhe Programit Buxhetor Afatmesëm, me qëllim adresimin e kërkesave mbështetje financiare të njësive të vetqeverisjes vendore në kuadër të garantimit të përmbushjes së detyrave të parashikuara në këtë projektligj.

Njëkohësisht Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, nëpërmjet nënkomisionit për pushtetit vendor do të ketë vëmendje të veçantë akomodimin e kërkesave dhe nevojave financiare të njësive të vetqeverisjes vendore, për

zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë projektligji në fazën e diskutimit dhe shqyrtimit të projektligjit për buxhetin e vitit 2019.

Së dyti: Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore

Anëtarët e komisionit diskutuan lidhur me parashikimin e bërë në projektligj për njohjen nga ministria përgjegjëse për çështjet e rinisë të një organizate të vetme si përfaqësuese kombëtare e organizatave rinore, e cila parashikohet të themelohet nga jo më pak se 30 organizata rinore dhe/ose për të rinjtë, me të paktën 1000 anëtarë që ushtrojnë veprimtarinë në një territor që mbulon 70 përqind të bashkive.

Referuar shpjegimeve të dhëna nga ministria përgjegjëse për rininë, krijimi i Organizatës Kombëtare Përfaqësuese Rinore, është bazuar në modelet e disa vendeve evropiane si: Serbia, Bullgaria, Finlanda etj.

Komisioni shqyrtoi dhe miratoi ndryshime në këtë dispozitë me qëllim garantimin të balancës së drejtë ndërmjet respektimit e normave kushtetuese në rastin e lirisë së organizimit nga njëra anë, dhe ndikimit që parashikohet të kenë organizata kombëtare përfaqësuese rinore në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të rinjve.

Ndryshimet e propozuara në këtë nen afirmojnë të drejtën e organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, për të themeluar mbi baza vullnetare Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore duke pranuar qëllimin, fushën e veprimtarisë dhe përcaktimet e tjera të kësaj organizate, të rregulluara në statutin e saj, ndërkohë që kriteret që duhet të përmbushë Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore, për t'u njohur si e tillë nga institucioni përgjegjës për rininë, të lidhura me qëllimin, anëtarësinë, shtrirjen territoriale dhe tagrat e përfaqësimit të organizatave themeluese parashikohen të përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Rezerva ligjore e parashikuar në këtë rast do të kontribuojë në kryerjen e një vlerësimi më objektiv, gjithëpërfshirës dhe transparent përpara përcaktimit të kriterëve që duhet të përmbushen nga organizatat rinore dhe për të rinjtë themeleuese të Organizatës Kombëtare Rinore.

Së treti, saktësimin në dispozitat e projektligjit të statusit juridik dhe kompetencave të Këshillit Kombëtar të Rinisë dhe Këshillit Vendor për Rininë

Anëtarët e Komisionit për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut diskutuan në lidhje me domosdoshmërinë e parashikimit në dispozitat e projektligjit, të statusit juridik, mënyrës së organizimit dhe kompetencave kryesore, që do të ketë Këshilli Kombëtar i Rinisë dhe Këshilli Vendor për Rininë.

Komisioni diskutoi edhe në lidhje me përcaktimin në dispozitat e projektligjit të përbërjes dhe ndarjes së raporteve të pjesëmarrjes që duhet të kenë në këto Këshilla organizatat rinore/dhe për të rinjtë dhe institucionet shtetërore duke marrë për analogji Këshillin Kombëtar për Barazinë Gjinore, Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile.

Në përfundim komisioni vlerësoi që çështjet kryesore që lidhen me: a) kompetencat e Këshillave; b) numrin e anëtarëve; c) raportin e pjesëmarrjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë; d) organin përgjegjës për krijimin e tij dhe emërimin e anëtarëve të përcaktohen me ligj duke deleguar rregullimin me akt nënligjor të çështjeve të lidhura me organizimin dhe funksionimin e Këshillave dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve.

V. RIFORMULIME NEN PËR NEN DHE REKOMANDIME PËR KOMISIONIN PËRGJEGJËS

1 Në përputhje me rregullat e teknikës legislative, përpara nenit 1 të projektligjit sugjerohet të shtohet një nen i ri me këtë përmbajtje:

*“Neni _____
Objekti*

“Objekti i këtij ligji është mbrojtja e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithpërfshirëse, krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë.”

Neni 1 i projektligjit të riformulohet si më poshtë:

*“Neni 1
Qëllimi*

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i veprimtarive, mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të të rinjve shqiptarë në diasporë si dhe financimin e veprimtarive rinore, në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti.

Pra, neni 1 i projektligjit të sjellë ndahet në dy nene në veçanta.

Neni 2

- Shkronja “c” sugjerohet të riformulohet me këtë përmbajtje:
“c) Hapësira rinore e sigurt”, është çdo hapësirë ku ushtrojnë veprimtari të rinjtë dhe që plotësojnë standardet e përcaktuara në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Në rastin e të rinjve me aftësi të kufizuara këto hapësira duhet të zbatojnë elementët e përshtatjes së arsyeshme në përputhje me shkallën dhe llojin e aftësisë së kufizuar.
- Në lidhje me shkronjën “d” sugjerohet heqja e shprehjes “organizatave rinore dhe shoqërive”. Ky sugjerim bëhet pasi organet përgjegjës për hartimin e politikave janë ministria përgjegjëse për fushën e rinisë dhe njësitë vendore për kompetencat që ushtrohen prej tyre. Organizatat rinore të krijuara si OJF nuk janë hartuese politikash. Ato mbështesin institucionet përgjegjëse në realizimin e politikave.
- Shkronja “dh” “Punonjës rinor” i rekomandohet komisionit përgjegjës të rishikohet duke vlerësuar heqjen e tij nga përmbajtja e këtij neni dhe e projektligjit në tërësi pasi nuk qartëson statusin e tij, nëse mund të jetë punonjës rinor një person që nuk ka përfunduar arsimin e lartë, grupmoshat që do të konsiderohen “punonjës rinor” etj.
- Shkronja “ë” sugjerohet të hiqet, kjo pasi parimi i subsidiaritetit është një parim që rregullon funksionimin e njësiteve të vetqeverisjes vendore, i përkufizuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjes vendore”.

- Në aspektin teknik shkronjat “g” dhe “gj” sugjerohet të riformulohen me këtë përmbajtje:

“g. “Organizatave rinore”, janë persona juridikë jofitimprurës, të krijuar dhe të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre, përfaqësimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse.

“gj. “Organizatave për të rinjtë”, janë persona juridikë jofitimprurës të krijuar dhe të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse, që në fushën e veprimtarisë së tyre kanë për qëllim edhe mbrojtjen e zhvillimin e interesave të të rinjve dhe që kanë përvojë në zbatimin e programeve me ndikim për të rinjtë”.

Neni 3 sugjerohet të riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 3

Parimet për mbështetjen e veprimtarisë së të rinjve

1. Mbështetja dhe fuqizimi i të rinjve bazohet në parimet e mëposhtme:

- a) Parimin barazisë dhe të mosdiskriminimit të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi;*
- b) Parimin e mundësive të barabarta dhe garantimit të pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e: arsimit, kërkimit shkencor, politikave financiare, punësimit, vullnetarizmit, mbrojtjes e përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizmit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integritetit dhe të mbrojtjes, teknologjisë së informacionit, sipërmarrjes dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve;*
- c) Parimin e lirisë së organizimit të iniciativave rinore dhe të vetëqeverisjes së organizatave;*
- ç) Parimin e subsidiaritetit;*

2. Ky ligj garanton mbrojtjen e të rinjve shtetas shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe të të rinjve shtetas e huaj ose persona pa shtetësi që kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë, si dhe të shtetasve të huaj me qëndrim të rregullt për motive të ndryshme, sipas legjislacionit në fuqi për të huajt.

Titulli i Kreut II të projektligjit sugjerohet të ndryshohet dhe të bëhet “Organizimi institucional”

Neni 4

Për këtë nen i rekomandohet komisionit përgjegjës, riformulimi ose heqja e tij pasi përmbajtja e këtij neni nuk është e qartë dhe për më tepër është e trajtuar në dispozita të tjera të projektligjit.

Neni 5

- Në shkronjën “a” pas fjalës politikat, sugjerohet të shtohen fjalët “programet, strategjitë...”.
- Shkronja “d” riformulohet me këtë përmbajtje:
“d. Monitoron standardet për ndërtimin e hapësirave rinore të sigurta dhe të aksesueshme për të rinjtë”.
- Pas shkronjën “ë” sugjerohet të shtohen shkronja “f”, “g” dhe “gj” me këtë përmbajtje:
*“f) Harton dhe propozon bazën ligjore në fushën e rinisë dhe të shërbimeve për të rinjtë;
g) Siguron ofrimin e shërbimeve për të rinjtë në bashkëpunim me institucione të tjera qëndrore, njësitë e vetqeverisjes vendore dhe me autoritetet të tjera, duke përcaktuar standardet në ofrimin e shërbimeve rinore dhe punës me rininë;
gj) siguron zhvillimin e konsultimeve me të rinjtë lidhur me politikat dhe programet rinore në vend si dhe programet e shkëmbimit rinor ndërkombëtar;”*

Neni 7

Pas pikës 2 sugjerohet të shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë nen, njësitë e vetqeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetqeverisjen vendore.”

Neni 8

- Në shkronjën “b” pas fjalës “monitoron” shtohet fjala “mbikëqyr”.
- Shkronja “dh” sugjerohet të ndryshohet me këtë përmbajtje:
“siguron financime nëpërmjet aplikimit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat transferohen mbi bazë vjetore në rastet kur miratohet një projekt shumëvjeçar”.
- Pas shkronjës “dh” sugjerohet të shtohen shkronjat “dh/1”, dhe “dh/2” dhe “dh/3” si më poshtë:
*“dh/1) Mbledh, administron dhe analizon të dhënat mbi situatën e të rinjve në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe njësitë e vetqeverisjes vendore;
dh/2) Raporton në mënyrë periodike pranë ministrisë përgjegjëse për rininë për situatën e të rinjve dhe zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ky ligj;
dh/3) Mbikëqyr ofrimin e shërbimeve rinore dhe të punës me të rinjtë nga organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë që përfitojnë mbështetje sipas parashikimeve të këtij ligji.”*

Neni 9 sugjerohet të riformulohet si më poshtë:

“Neni 9

Këshilli Kombëtar i Rinisë

- 1. Këshilli Kombëtar i Rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë ministrit përgjegjës për rininë. Këshilli Kombëtar i Rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:*
 - a) I paraqet ministrit përgjegjës për rininë, politikat prioritare, buxhetin dhe veprimtaritë në fushën e rinisë;*
 - b) Propozon drejtimet dhe programet kryesore për mbështetjen dhe fuqizimin dhe pjesëmarrjes së të rinjve;*
 - c) Jep mendim për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe monitoron zbatimin e saj.*
 - d) Miraton raportin vjetor mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe situatës së të rinjve.*
- 2. Këshilli Kombëtar i Rinisë kryesohet nga ministri përgjegjës për rininë dhe ka në përbërje 14 deri në 16 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Rinisë emërohen me udhër të ministrit përgjegjës për rininë.*
- 3. Kriteret dhe procedurat e zgjedhjes së anëtarëve, si dhe mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Rinisë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”*

Neni 10 sugjerohet të ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 10 Këshilli vendor i rinisë

- 1. Këshilli Vendor i Rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Këshilli Vendor i Rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:*
 - a) Këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;*
 - b) Vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;*
 - c) Propozon përmirësime të politikave vendore rinore si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë.*
 - ç) Bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.*
- 2. Këshilli vendor i rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e Këshillit Vendor të Rinisë emërohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.*
- 3. Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Vendor të Rinisë, miratohen me vendim të këshillit bashkiak, duke iu referuar për aq sa është e mundur kriterëve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për Këshillin Kombëtar të Rinisë.”*

Neni 11

- Në pikën 1 fjalët "...organizohen apo transformohen..." sugjerohet të hiqet.
- Në aspektin teknik, pika 2 sugjerohet të riformulohet me këtë përmbajtje:

"2. Organizat rinore duhet të përmbushin këto kritere:

- a) të jenë të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse;*
- b) të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës aktivitetet dhe veprimtari rinore;*
- c) të paktën, 70 përqind e anëtarëve të saj të jenë të rinj;*

Neni 12

- Në pikën 1 fjalët "...organizohen apo transformohen..." sugjerohet të hiqet.
- Në aspektin teknik me qëllim qartësimin e kritereve të organizatës për të rinjtë, pika 2 sugjerohet të riformulohet me këtë përmbajtje:

"2. Organizat për të rinjtë duhet të përmbushin këto kritere:

- a) të jenë të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse;*
- b) të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës aktivitetet dhe veprimtari rinore;*
- c) të kenë zbatuar të paktën, për një periudhë 3 vjeçare në mënyrë të vazhdueshme projekte e programe me impakt të rinjtë;*
- ç) të mos jenë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;*

- Sugjerojmë që pika 4 të kalojë si pikë 3, dhe pika 3 të kalojë si pikë 4 e nenit.

Neni 13 sugjerohet të ndryshohet me këtë përmbajtje:

"Neni 13

Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore

- 1. Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore është një organizatë që themelohet, organizohet dhe funksionon në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse dhe e ushtron veprimtarinë në përputhje me statutin e saj.*
- 2. Të drejtën për të themeluar Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore e kanë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, të cilat pranojnë qëllimin, fushën e veprimtarisë dhe përcaktimet e tjera të kësaj organizate, të rregulluara në statutin e saj.*
- 3. Kriteret që duhet të përmbushë Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore, për t'u njohur si e tillë nga institucioni përgjegjës për rininë, miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.*

Neni 14

- Sugjerohet që titulli i nenit të ndryshohet dhe të bëhet “Puna Rinore”.
- Në vijim të rekomandimeve për shkronjën “dh” të nenit 2 lidhur me përkufizimin e “punonjësit rinor” i rekomandohet Komisioni përgjegjës të rishikojë duke vlerësuar heqjen e parashikimeve të pikave 3, 4 dhe 5 të këtij neni.

Neni 15

- Pika 3 sugjerohet të ndryshohet me këtë përmbajtje:

“3. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Neni 16

- Fjalja hyrëse e pikës 1 të nenit sugjerohet të riformulohet si më poshtë:

“1. Fondi grant i dedikuar për rininë sipas nenin 15 pika 1 shkronja “a” të këtij ligji, përdoret vetëm për: ...”

- Pika 2 sugjerohet të riformulohet si më poshtë:

“Projektet e ndërtimit ose rikonstruksionit të objekteve publike dhe infrastrukturës rinore, paraqiten dhe miratohen në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, duke garantuar zbatimin e elementëve të përshtatjes së arsyeshme, sipas legjislacionit në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar.”

- Pas pikës 2 sugjerohet të shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

“3. Planifikimi dhe zbatimi i procedurave të shpërndarjes së fondit grant të dedikuar për rininë, procedurat e përzgjedhjes, kontratat e nënshkuara me organizatat përfituese, si dhe raportimet për shpenzimin e fondeve të dhëna, sipas këtij ligji, publikohen në faqen zyrtare të institucionit përgjegjës për rininë.

4. Institucioni përgjegjës për rininë shkëmben informacion me institucionin përgjegjës për mbështetjen e shoqërisë civile për organizatat rinore/organizatat për të rinjtë përfituese të fondit grant të dedikuar për rininë.”

Neni 18

- Në pikën 3 fjalët “sipas rregullave të koordinimit të përcaktuara nga autoriteti rregullator koordinues” të zëvendësohen me fjalët “sipas legjislacionit në fuqi”.
- Pas pikës 3 sugjerohet të shtohen pikat 4 dhe 5 si më poshtë:

“4. Rregulla të hollësishme për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

“5. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale sipas parashikimeve të këtij neni, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 19

Në këtë nen i rekomandohet komisionit përgjegjës që të rishikojë afatin e nxjerrjes së akteve nënligjore nga nëntë në gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

TË PËRGJITHSHME

1. Termat e përkufizuar në nenin 2 të projektligjit në këndvështrim të rregullave të teknikës legjislativë të renditen sipas rendit alfabetik.
2. Rishikimi në tërësi i referencave ligjore të bëra në nene specifike të projektligjit për shkak të ndryshimeve që mund të vijnë nga rinumërimi i dispozitave ligjore.
3. Rinumërimi i neneve të projektligjit bazuar në sugjerimet për shtim dhe heqje të dispozitave ligjore.
4. Në dispozitën e nxjerrjes së akteve nënligjore të evidentohen saktësisht duke marrë në konsideratë ndryshimet e mundshme të referencave dhe propozimet e bëra, të gjitha dispozitat ligjore që delegojnë miratimin e akteve nënligjore.

VII. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se:

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm e miratoi atë dhe u shpreh dakord për ta përcjellë mendimin Komisionit përgjegjës dhe për votim në seancë plenare.

VASILIKA HYSI

ULSI MANJA

RELATORE

KRYETAR